

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**“KB 01” SH.P.K.**

Sot, më date **03/04/2024**, UNE, i nënshkruari:

- **Klevis BRESHANAJ** lindur në Vlorë, më 09/02/2001, shtetas Shqiptarë, mbajtes i leternjoftimit ID K10209072M, madhor me zotësi të plote juridike për të vepruar

në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” kam vendosur të themeloj një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emëruar “**KB 01**” SH.P.K. (më poshtë referuar si “Shoqëria”), duke nënshkruar këtë Akt Themelimi.

Aktiviteti i kësaj Shoqërie do të rregullohet nga Statuti i saj.

**Neni 1**

Emri i Shoqërisë është: “**KB 01**” SH.P.K

**Neni 2**

(1) Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Vlorë, Rruga Gjergj Kastrioti, Lagjia Rilindja, Objekt nr.3, kati 1

(1.1) Shoqëria ka të drejtë që ta ndryshojë adresën e selisë së saj, dhe të shtojë adresën e reja të ushtrimit të aktivitetit.

(2) Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon: **kbreshanajexchange@yahoo.com**  
Shoqëria ka të drejtë të hapë degë apo filiale në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, dhe jashtë saj.

**Neni 3**

-Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat, për një periudhë të pacaktuar kohore dhe fillon që prej datës së regjistrimit të saj në Regjistrin e Shoqërive Tregtare në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

**Objekti i veprimtarisë së shoqërisë**

**Neni 4**

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

Klevis Breshanaj 

- Zyre e kembimit valuator Exchange. Veprimtari e agjentit per transferim parash ne emer dhe per llogari te nje subjekti financiare jo banke. Veprimtari e agjentit per arketimin e pagesave per te trete ne emer dhe per llogari te nje subjekti financiar jo banke. Veprimtari e agjentit komisioner. Sherbim Union Net –Western Union. Agjensi Udhetimi. Shit-blerje automjetesh, dhenie me qera automjetesh. Siguracion biznesi, jete, automjetesh. Imobiliare (shitblerje dhe dhenie me qera apartamentesh banimi, lokale etj)

- Shoqeria mund te krycje cfaredo lloj sherbimi qe paraqitet ne pajtueshmeri me objektin e saj dhe qe eshte lidhur me kete object.

- **Megjithate shoqeria ka te drejte qe te shtojte dhe te ndryshoje objektin e veprimtarise se saj me vendim te asamblese se ortakeve.**

### **Neni 5 Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është **2.500.000** (dy milion e pesëqind mijë ) Lekë, I ndare ne 1 (një) kuotë me vlere 2.500.000 (dy milion e pesëqind mijë) leke. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku themelues **Klevis BRESHANAJ** : Zotërues I 100% (njëqind përqind) te kuotave (1 Kuotë) me vlerë të përgjithshme prej **2'500'000** (Dy milion e pesëqind mijë) Leke që përbën **100 %** të kapitalit themeltar të shoqërisë

Kontributi i ortakëve do të jetë në para .

### **Neni 6**

#### **Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

Shtimi ose pakesimi i kapitalit themeltar mund te behet vetem pasi Asamblea e ortakeve me shumice e ka dekretuar kete dhe per me teper te gjithë ortaket jane te detyruar qe ta repektojne dhe te kontribuojne ne para ose ne natyre ne baze te vendimit te shumices se asamblese.

Klevis Breshanaj. 

## **Neni 7**

### **Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit te një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e te drejtat që rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen pëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërise
- b) shitblerjes;(me te drejten e parablerjes nga ana e ortakëve).
- c) trashëgimise;
- d) dhurimit;
- e) cdo menyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë ligjerisht të trasferueshme ndërmjet ortakëve, përsa nuk parashikohet ndryshe në statut. Pjesët e kapitakit themeltar janë ligjerisht të trasferueshme me rrugë trashgimnie.

## **Neni 8**

### **Organi Vendimmarres**

Asambleja e Ortakëve është organi i vetem vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetem vendimmarrës i shoqërisë që miraton cdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme, kuorumi, marrja e vendimeve ,përfashtimi nga e drejta e votës dhe te tjera modalitete per funksionimin e organit vendimmarres percaktohen ne statutin e shoqërise.

## **Neni 9**

### **Administrimi**

Aministratori i shoqërise emerohet **Z. Klevis BRESHANAJ** lindur ne Vlore, me 09/02/2001, shtetas shqiptar , mbajtes i leternjofimit ID K10209072M , madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar., i zgjedhur per nje periudhe **5** vjecare me te drejte rizgjedhje.

Kompetencat dhe përgjegjësitë e Administratorit jane te percaktuara qarte ne statutin e shoqërise.

## **Neni 10**

### **Viti financiar-ekspertët**

Viti financiar i shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përfashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

Klevis Breshana; 

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxierien e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e ta dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

#### **Neni 11**

#### **Prishja-riorganizimi i shoqërisë**

Modalitetet për prishjen dhe riorganizimin e shoqërisë janë të percaktuara në statutin e shoqërisë në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i Ndryshuar.

#### **Neni 12**

Akti i Themelimit është hartuar në 4 kopje origjinale.

#### **ORTAKËT E SHOQËRISË**

**Klevis BRESHANAJ**

